



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 3311... Prot. Tiranë, më 05.08.2024

Nr. 3311... Prot. Tiranë, më 05.08.2024

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 124 , Datë 05/08/2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 112, DATË 05.07.2024,
“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2024 — 2025”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”,

URDHËROJ

1. Në kalendarin e miratuar sipas urdhrit të përbashkët nr.112, datë 05.07.2024, “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024 — 2025, në shtojcën nr.1, në kolonën e referencave në pikën 1, Kreu IV i udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, bëhen ndryshimet sa më poshtë:

SHTOJCA NR. 1

Periudha/Datat

KREU IV:

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

<i>Nr.</i>	<i>Referenca në Udhëzim</i>	<i>Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit</i>	
Kreu IV			
		Ishte	Bëhet
1	Kreu IV, pika 1	Kandidati që kërkon të ndjekë studimet në një program të dytë studimi apo të transferojë studimet, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ka të drejtë të aplikojë deri në 5 (pesë) programe studimi pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat 02 – 03 shtator 2024.	Kandidati që kërkon të ndjekë studimet në një program të dytë studimi apo të transferojë studimet, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ka të drejtë të aplikojë deri në 5 (pesë) programe studimi pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat 02 – 13 shtator 2024.


2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve
Arsimore

Drejtori i Përgjithshëm

Znj. Aurora BALLIU



Për Qendrën Ndërinstitucionale të
Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtori i Përgjithshëm

Z. Arjan XIJELI

